



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Numri i Çështjes	71041-02001-11-2016	Data e Regjistrimit	11/15/2016
Numri i Vendimit	11-2017-1994	Data e Vendimit	4/26/2017

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:

KRYESUES: Rexhep Bekteshi

ANËTAR

SEKRETARE Brunilda Dizdari

Objekti: Heqjen (shfuqizimin) e sekuestros vënë në zbatim të vendimit të sekuestros në lidhje me procedimin penal nr.922/2016.

Baza Ligjore : Neni 212 i K.Pr.Penale.

Përmbledhja e vendimit:

Në gjykim mori pjesë **prokurorja e çështjes Rabiana Halili**.<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

Gjykata shqyrtoi materialet e çështjes dhe provat e paraqitura, në seancë gjyqësore që i administroi në gjykim dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dëgjoi kërkuesen ***** dhe avokatin mbrojtës të saj, **që i kërkuan gjykatës:** Pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e Vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për pjesën që ka vendosur sekuestrimin e shumave të depozituara nga kërkuesja ***** e bashkëshorti i saj, shtetasi italian Russo Anacleto, në llogarinë bankare pranë Bankës Veneto në Durrës në zbatim të nenit 212 të Kodit Procedurës Penale.

Prokurorja e çështjes Rabiana Halili në përfundim të shqyrtimit gjyqësor deklaroi se nga ***** e Rrethit Gjyqësor Durrës po kryhen hetime për veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" në bazë të nenit 287 të Kodit Penal dhe vendimi i sekuestrimit i datës 01.06.2016 i marrë nga ***** është e mbështetur në provat e faktet që janë grumbulluar në fazën e hetimeve paraprake e për shkaqet e mësipërme i kërkoi gjykatës të rrëzojë kërkesën e bërë nga kërkuesja ***** si të pa mbështetur në prova e në ligj.

Gjykata pasi shqyrtoi materialet e çështjes,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Vëren:

Se ***** e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal dhe po kryhen hetime për veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” që parashikohet nga neni 287 i Kodit Penal dhe nga hetimet e kryera del se: <?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

Më datë 06.05.2016, specialistët për hetimin e veprave penale të narkotikëve në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës, kanë realizuar arrestimin e shtetasit Hajri Balla, i datëlindjes 1963, dhe banues në rrethin e Durrësit, me qëllim ekstradimin e tij në Itali.

Ai nga autoritetet e drejtësisë italiane është shpallur në kërkim ndërkombëtar pasi ndaj shtetasit shqiptar Hajri Balla është lëshuar Urdhëri i Arrestit Nr. 11578/12 NR., datë 15.08.2015, për veprën penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike” që parashikohet nga nenet 10, 73 e 74 të Kodit Penal Italian e Dekretit Nr. 309 i vitit 1990 të këtij shteti.

Vepra penale e mësipërme parashikohet dhe nga neni 283 i Kodit Penal Shqiptar si vepër penale e që përcakton dënim penal me burgim që fillon nga 7 vjet burgim.

Nga Policia Gjyqësore Durrës përpara arrestimit janë kryer veprime paraprake investigimi lidhur me transaksionet e aktivitetet pasurore të luajtshme e të paluajtshme të kryera nga i arrestuari Hajri Balla, me qëllim hetimin e veprimtarisë së paligjshme të kryer prej tij.

Është konstatuar me prova se shtetasi Hajri Balla, bashkëshortja e tij, Nafije Balla, e familjarë të tjerë të tij, kanë bërë kreditime dhe debitime në llogari të ndryshme bankare, në bankat “Raiffeisen”, “Intesa San Paolo”, etj., shuma të konsiderueshme në Lekë dhe në Euro.

Nga investigimi në “Western Union” Bank del se i arrestuari me qëllim ekstradimi, Hajri Balla, më datë 22.07.2014, ka kryer një transfertë në drejtim të shtetasës (kërkueses) ***** *****; që është e martuar me shtetasin italian Russo Anacleto, dhe është me qëndrim në Itali.

Ajo ka lidhje familjare me të arrestuarin Hajri Balla dhe nga hetimet e mëtejshme del se kërkuesja ***** ***** , më datë 17.03.2010 i ka dhënë hua shtetasit Hysni Sula, shumat 40.000 Euro e shumën 5.000.000 lekë.

Hetimet e kryera kanë vërtetuar se në këtë transaksion është përfshirë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

si palë huadhënëse dhe shtetasi italian Russo Anacleto, i datëlindjes 1948, që kërkuesja ***** deklaron se është bashkëshorti i saj, me banim në Itali.

Rezulton se më datë 21.01.2015, është bërë rinovimi i kontratës së mësipërme me Akt Noterial (Kontrata me Nr. 153 Rep. e Nr. 69 Kol.).

Rezulton se shtetasi Hajri Balla ka një shtëpi banimi 3 katëshe në fshatin Pjezë të Shijakut dhe është i dënuar nga autoritetet e drejtësisë italiane për trafikim të lëndëve narkotike e arrestimi i tij nga autoritetet policore shqiptare është bërë me qëllim ekstradimin e tij në Itali.

***** e Rrethit Gjyqësor Durrës në vazhdim të hetimeve, pasi ka siguruar provat e mjaftueshme me Vendimin e datës 01.06.2016, ka vendosur sekuestrimin në Bankat e Nivelit të Dytë të shumave të depozituara në llogaritë rrjedhëse, nga shtetasit Hajri Balla, Nafije Balla, Marsida Balla, Geraldo Ball, të kërkueses ***** e shtetasve Sokol ***** e Manjola *****.

Vendimi i mësipërm është marrë në funksion të sigurimit të provave të tjera dhe të zgjerimit të hetimeve lidhur me veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, që parashikohet nga neni 287 të Kodit Penal dhe u është dërguar për veprim Bankave të Nivelit të Dytë.

Rezulton se nga “Veneto Bank” me Shkresën e datës 07.06.2016, organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës i është kthyer përgjigje se kërkuesja (shtetasja) ***** ka dy depozita në këtë bankë të cilat u bllokuan sipas Vendimit të sekuestrimit të datës 01.06.2016 të marrë nga organi i akuzës.

Bashkë me shkresën e mësipërme “Veneto Bank” i ka dërguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe dokumentacionin përkatës për dy depozitat e mësipërme të kërkueses ***** , që u shqyrtuan nga Gjykata, në gjykim bashkë me materialet e tjera të paraqitura nga organi i Prokurorisë.

Nga ana e kërkueses ***** më datë 14.11.2016, është paraqitur në Gjykatë kërkesa me objekt: Heqjen (shfuqizimin) e Vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës të datës 01.06.2016, për vendosjen e sekuestrimit të dy llogarive të mësipërme në “Veneto Bank”, që i përkasin kërkueses ***** dhe bashkëshortit të saj, Russo Anacleto, shtetas italian.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Në gjykim kërkesja dhe mbrojtëse i saj, paraqitën si provë disa dokumenta të lëshuara nga organet e shtetit italian dhe pretenduan se shumat e depozituara në dy llogaritë (depozitat) në “Veneto Bank” nuk kanë lidhje me aktivitetin e paligjshëm të kryer nga i arrestuari Hajri Balla etj.

Gjykata shqyrtoi me kujdes të gjithë materialet e çështjes dhe konkludon se nga ***** e Rrethit Gjyqësor Durrës, Vendimi i datës 01.06.2016 që ka vendosur ndër të tjera dhe sekuestrimin (bllokimin) e shumave të depozituara në dy llogaritë (depozitat) nga kërkesja ***** në “Veneto Bank” është bërë në përputhje të plotë me ligjin procedural penal dhe pasi janë siguruar prova e fakte të mjaftueshme.

Vendimi është marrë për realizimin e një hetimi të plotë e objektiv të çështjes penale për veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale” që parashikohet nga neni 287 i Kodit Penal.

Për shkaqet e mësipërme, Gjykata vlerëson se kërkesa e bërë nga kërkesja ***** nuk është e mbështetur në prova dhe ligj e duhet rrëzuar.

Për keto arsye:

Baza Ligjore:

Në zbatim të nenit 212 të Kodit Procedurës Penale, Gjykata:<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Vendosi:

Rrëzimin e kërkesës së kërkujeses ***** në objekt: Heqjen (shfuqizimin) e Vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës i datës 01.06.2016, për vendosjen e sekuestrimit (bllokimit) të shumave që kërkujesja ***** bashkëshorti i saj Russo Anacleto, kanë depozituar në dy depozita në “Veneto Bank”, si të pa mbështetur në prova e në ligj.<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij.

U shpall sot më datë 24.04.2017.

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.